REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 217/25 Dt. 02.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, për lejimin e realizimit (krijimit) të programit: "Enterprise Resource Planning-ERP" (Sistemi i Integruar Soufterik) për digjitalizimin e menaxhimit të proceseve të brendshme për Drejtoritë Komunale në Komunën e Prizrenit", kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Ky projekt realizohet prej kodit buxhetor-mallra dhe shërbime të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave.

3. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Sektori i Prokurimit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 214/25 Dt. 02.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 37 të Ligjit nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Raporti i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, bazuar në Raportin e ekspertëve, lidhur me rrëshqitjen e dheut në rrugën e një lagjeje të fshatit Leskovec me që rast janë prekur nga rrëshqitja e dheut disa shtëpi dhe familje të kësaj lagjeje.

2. Obligohen organet kompetente që me qëllim të parandalimit të përkeqësimit të mëtutjeshëm të situatës në terren, që menjëherë të ndërmarrin veprime dhe masa konkrete ligjore si në vijim:

   2.1. Të bëhet evakuimi i menjëhershëm i banorëve nga shtëpitë e rrezikuara,

   2.2. Të sigurohen banesa të përkohshme dhe të sigurta për këta qytetarë,

   2.3. Komuna do të mbulojë qiranë për familjet e evakuuar deri në zgjidhjen e përhershme të problemit.

3. Obligohet Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, që kohë pas kohe të raportoj para organeve kompetente lidhur me ecurinë e marrjes së masave për tejkalimin e kësaj fatkeqësie.

4. Obligohet Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe organet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 215/25 Dt. 02.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për lejimin e mjeteve**

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të shpenzimeve komunale- të faturave të energjisë elektrike, të ujit dhe mbeturinave, etj., të krijuara (shpenzuara) nga institucionet vartëse të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, siç janë: Stadiumi i Qytetit "Përparim Thaqi" dhe Shtëpia e Kulturës në fshatin Zhur, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të pagesave të faturave përkatëse, lejohen mjetet e nevojshme financiare.

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve dhe shpenzime komunale të Komunës së Prizrenit.

3. Mjetet e lartcekura do të lejohen pas parashtrimit të faturave përkatëse.

4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 216/25 Dt. 02.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 44 dhe 53 lidhur me nenin 49 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesë së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për shfuqizimin e vendimit**

1. Shfuqizohet në tërësi Vendimi nr. 01 nr. 138/24, i datës 23.02.2024, i cili ka të bëjë me themelimin dhe emërimin e Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të ardhur nga OJQ-të nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit për ndarje të subvencioneve.

2. Obligohet Drejtoria e së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Komisionit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS ∗ REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit ∗ Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 220/25 Dt. 03.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e rregullimit të transportit linjor urban-periferik në relacionin Skorobisht-Prizren-Skorobisht në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet zhvillimi i procedurave ligjore-shpallja publike për rregullimin e këtij transporti.

2. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 221/25 Dt. 03.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e rregullimit të transportit linjor urban-periferik në relacionin Lubizhdë-Prizren-Lubizhdë në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet zhvillimi i procedurave ligjore-shpallja publike për rregullimin e këtij transporti.

2. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 223/25 Dt. 03.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja b) dhe d) të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008"), neni 12 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin, dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, nenit 15 të Rregullores 001-011-141691 datë 28.09.2023 për Organizimin, Funksionimin, dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Prizrenit, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për lejimin e mjeteve për kompensim të kryetarëve të Këshillave të Lokal të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjet Urbane

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për kompensim për kryetarët e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjet urbane në tërë territorin e Komunës së Prizrenit.

2. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjet urbane bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative.

3. Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.

4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e kryetarëve të Këshillave lokal të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjet urbane të Komunës së Prizrenit.

6. Obligohet Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 219/25 Dt. 03.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 44 dhe 53 lidhur me nenin 49 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesë së Idriz Kryeziut, kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M
**Për revokimin e autorizimit**

1. Revokohet në tërësi Autorizimi 01 nr. 157/25 datë 27.02.2025 me të cilin, Idriz Kryeziu, i sistemuar në vendin e punës-zyrtar ligjore në Drejtorinë e Arsimit dhe Shkencës në Komunën e Prizrenit, është autorizuar që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme procedurale dhe ligjore për ti nënshkruar aktet ligjore (kërkesa, ankesa, përgjigjeje në padi, etj.) të cilat akte janë të lidhura me Drejtorinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. Obligohet Drejtoria Arsimit dhe Shkencës, i lartcekuri dhe Përfaqësuesi Ligjor për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
- Të lartcekurit,
- Përfaqësuesit Ligjor,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 222/25 Dt. 03.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Sevil Kazaz-anëtare e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Sevil Kazaz-anëtare e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, bazuar në ftesën zyrtare të kryetarit të Komunës Avcilar të Republikës së Turqisë, drejtuar Komunës së Prizrenit me qëllim të pjesmarrjës së një delegacioni zyrtar të Komunës së Prizrenit në Samitin Global për Ndërtimin e të Ardhmes së Qëndrueshme për Gratë dhe Rininë, që do të mbahet nga data 07 prill 2025 deri me 11 prill 2025.

2. Në këtë Samit, të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi do të marrin pjesë: Sevil Kazaz, Mimoza Bushrani, Drita Qenaj, Shukrije Berisha dhe Naxhije Memaj,-anëtare të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohet pagesa e shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dhe të mëditjeve.

3. Ky Samit organizohet në bashkëpunim me Institutin Amerikan për Diplomaci dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komunën Avicar.

4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

5. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 230/25 Dt. 04.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b, d dhe g të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) neni 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, nenit 9 të Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M
## Për formimin e Komisionit

1. Themelohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të ardhur nga OJQ-të dhe Individëve nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit për ndarje të subvencioneve. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:

   1.1. Arben Rashkaj,...................... kryesues,
   1.2. Sahadete Sadikaj....................anëtare,
   1.3. Imerdin Kukaj,.......................anëtar,
   1.4. Xhevdet Dervishaj, ...............anëtar rezervë.

2. Detyrat e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve të përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, janë të caktuara në Rregulloren MF –Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe ligjet dhe aktet të tjera nënligjore që e rregullojnë këtë lëmi.

3. Mandati i Komisionit të cekur si në pikën 1 të këtij Vendimi do të jetë konform paragrafit 3 të nenit 9 të Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komisioni i lartcekur për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Komisionit të lartcekur,
- Arkivës së Kryetarit

REPUBLIKA E KOSOVËS ★ REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit ★ Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 229/25 Dt. 04.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e realizimit të projektit: "Ndërtimi i objekteve kulturore, rinore dhe sportive në Prizren dhe Fshatra", të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nr. 54673.

3. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 226/25 Dt. 04.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale, kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale, për lejimin e hartimit të projekteve të ndryshme ideore dhe kryesore për ndërtim, renovim, dhe legalizim sipas nevojës dhe kërkesës së kësaj Drejtorie, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Kontrata do të jetë dyvjeçare (kontratë kornizë).

3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale -mallra dhe shërbime.

4. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenie Sociale, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 227/25 Dt. 04.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 29 paragrafi 1.1, neni 30 paragrafi 2 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M
**Për lejimin e mjeteve financiare për pagesën e nënave (lehona) që kanë lindur fëmijë gjatë vitit 2024**

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për pagesën e nënave (lehona), që kanë lindur fëmijë gjatë vitit 2024, si në vijim:

   1.1. Për fëmijën e parë (1) të lindur ndahet shuma financiare prej 250.00 €,
   1.2. Për fëmijën e dytë (2) të lindur ndahet shuma financiare prej 300.00 €,
   1.3. Për fëmijën e tretë (3) e më tepër të lindur ndahet shuma financiare prej 350.00 €.

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.

3. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komisioni i formuar me vendim 01 nr. 135/25, datë 20.02.2025 dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- Komisionit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 225/25 Dt. 04.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe lejohet fillimi i procedurave ligjore nga Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastër, për parcializimin e pronës (copëtimi i parcelës) me nr. të ngastrës kadastrore 11048-16 ZK-Prizren sipas gjendjes faktike (skicës) në terren.

2. Parcializimi (copëtimi i parcelës) bëhet me qëllim të realizimit të projektit: "Ndërtimi i objektit Qendra e Autizmit".

3. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastër,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 224/25 Dt. 04.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet ftesa e Shoqatës së Festivaleve Evropiane, Festivalit Ndërkombëtar të Edinburgut, Festivalit të Edinburgut dhe Këshillit të Qytetit të Edinburgut, drejtuar kryetarit të Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, dhe drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit Adem Morina, për pjesëmarrje në Samitin e Festivaleve të Arteve 2025, që mbahet nga data 27 prill 2025 deri me 30 prill 2025 në Edinburg të Mbretërisë së Bashkuar.

2. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën 26 prill 2025 dhe kthimi me 04 maj 2025, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, të akomodimit, ushqimit, për pagesë të mëditjeve si dhe të shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurit.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Kabineti i Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Kabinetit të Kryetarit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 228/25 Dt. 04.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Çelë Lamaj-drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prizrenit dhe Defrim Zajmi nga Kabineti i Kryetarit të Komunës së Prizrenit, bazuar në ftesën e GIZ-it, për pjesëmarrje në Konferencën Rajonale "Green Transport Solutions", që do të zhvillohet nga data 24 prill 2025 deri me 25 prill 2025, në Ohër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet financiare për pagesë të shpenzimeve të udhëtimit dhe të mëditjeve si dhe për shpenzime të paparashikuara për të lartcekurit.

2. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën 23 prill 2025 dhe kthimi me 26 prill 2025.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Të lartcekurve,
  - Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 231/25 Dt. 07.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Ligjit nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për formimin e Grupit Punues**

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues që do të punoj ne dokumentin: "Plani Komunal për Përfshirjen e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve për vitet 2025-2026". Anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:

   1.1. Islam Elshani.........................................................kryesues,
   1.2. Derya Kala ............................................................anëtare,
   1.3. Osman Osmani, ..................OJQ, "NVK",.......... anëtar,
   1.4. Fatmir Menekeshe, .....OJQ "Durmish Asllano". anëtar,
   1.5. Halil Lika, ..............................................................anëtar,
   1.6. Adelina Hoxha.........................................................anëtare,
   1.7. Edona Hashani, .....................................................anëtare.

2. Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 1 të këtij Vendimi është që të përcjellë ecurinë e dokumentit: "Plani Komunal për Përfshirjen e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve për vitet 2025-2026", duke filluar nga përkthimi, dërgimi në Komitetin për Komunitete, Komitetin për Politik dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës për miratim.

3. Obligohet Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Grupi Punues për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Zyrës për Komunitete dhe Kthim,
- Të emëruarve,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 233/25 Dt. 10.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së menaxherit të kontratës në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për lejimin e ndryshimeve në projekt

1. Miratohet kërkesa e menaxherit të kontratës në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për lejimin e ndryshimeve të pozicioneve (kolaudim të kontratës) në projektin: "Rregullimi i infrastrukturës në Grazhdanik, rrugët dhe kanalizimi" projekt dy vjeçar, i cili është duke u realizuar konformë kontratës me nr. të prokurimit 622-24-10402-521.

2. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit, OE që është duke i zhvilluar punimet dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- OE,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 236/25 Dt. 14.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për lejimin e udhëtimit zyrtar**

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Muhamet Bajramit-udhëheqës në Sektorin për Mjedis dhe Menaxhimin e Mbeturinave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për në Berat të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorin (vizitë studimore) me temën: "Vizitë studimore për Ekonomi Qarkore për menaxhimin e mbeturinave, që do të mbahet nga data 14 prill 2025 deri me 16 prill 2025, kështu që, për këtë qëllim, lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.

2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës së Prizrenit.

3. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 248/25 Dt. 15.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes Komunës së Prizrenit, DVV International dhe OJQ THY 01 Nr.199/25, të datës 24.03.2025 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për lejimin e mjeteve për bashkëfinancim të projektit**

1. Lejohen mjetet financiare për bashkëfinancim në realizimin (financimin) e projektit që ka për qëllim konsolidimin e përpjekjeve për krijimin e mundësive për të rinjët dhe të rriturit përmes ofertave holistike të arsimit joformal dhe informal. Ky bashkëfinancim është i bazuar në nenin 3 të Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes Komunës së Prizrenit, DVV International dhe OJQ THY 01 Nr.199/25, të datës 24.03.2025 (aneksi 1 i këtij Memorandumi), kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 10.000,00 € (dhjetëmijë euro).

2. Zyrtare Monitoruese e projektit nga Komuna e Prizrenit, caktohet Laura Kelmendi Selaj.

3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit të lidhur në mes Komunës së Prizrenit, DVV International dhe OJQ THY 01 Nr.199/25, të datës 24.03.2025.

4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.

5. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe zyrtarja monitoruese për zbatimin e vendimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Zyrtares monitoruese,
- DVV International,
- OJQ THY,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 249/25 Dt. 15.04.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes Komunës së Prizrenit dhe OJQ "Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug (AZHR Jug) 01 Nr.200/25, të datës 24.03.2025 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për lejimin e mjeteve për bashkëfinancim të projektit

1. Lejohen mjetet financiare për bashkëfinancim në realizimin (financimin) e projektit që ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës në komunën e Prizrenit si dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale në komunën e Prizrenit. Ky bashkëfinancim është i bazuar në nenin 3 të Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes Komunës së Prizrenit dhe OJQ "Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug (AZHR Jug) 01 Nr.200/25, të datës 24.03.2025, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 28.980,00 € (njëzetë e tetëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë).

2. Zyrtar Monitorues i projektit nga Komuna e Prizrenit, caktohet z. Halil Lika.

3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit të lidhur në mes Komunës së Prizrenit dhe OJQ "Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug (AZHR Jug) 01 Nr.200/25, të datës 24.03.2025.

4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.

5. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe zyrtari monitorues për zbatimin e vendimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Zyrtarit monitorues,
- AZHR Jug,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 246/25 Dt. 15.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, të nenit 8 dhe 19 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruar ndaj listës së përfituesve të bursave komunale të publikuara nga ana e Komisionit që ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave (aplikacioneve) dhe ndarjen e bursave për studentët, për vitin akademik 2024/2025. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:

   1.1. Islam Osmankaj,
   1.2. Haxhere Gavazaj,
   1.3. Nezir Osmani.

2. Komisioni i përberë si në pikën 1 të këtij Vendimi, në mbledhjen e tij të parë do të zgjedhë kryesuesin e komisionit.

3. Komisioni, nga pika 1 e këtij Vendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me konkursin e shpallur për ndarjen e bursave dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

5. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe të emëruarit e këtij Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
- Të emëruarve,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 245/25 Dt. 15.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 paragrafi f dhe g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Shoqatës së Sindikatës së Administratës të Komunës së Prizrenit, 01 nr. 243/25 të datës, 15.04.2025, nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M
## Për lejimin e mjeteve për bashkëfinancim

1. Me këtë Vendim lejohen mjetet financiare për bashkëfinancim në realizimin e projektit: "Ngritja e kapaciteteve dhe bashkëpunimi ndërkomunal i shërbyeseve civil të administratës të Komunës së Prizrenit", i cili bashkëfinancim është i bazuar në nenin 3.4 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Shoqatës së Sindikatës së Administratës të Komunës së Prizrenit, 01 nr. 243/25 të datës,15.04.2025, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 70% për secilin pjesëmarrës në këtë projekt (vizitë studimore).

2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Marrëveshja e Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Shoqatës së Sindikatës së Administratës të Komunës së Prizrenit, 01 nr. 243/25, të datës 15.04.2025.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Shoqata Sindikale e Administratës të Komunës së Prizrenit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- ShSA të Komunës së Prizrenit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 247/25 Dt. 15.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për lejimin e udhëtimit zyrtar**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Naim Kukaj, zyrtar i lartë ligjor në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Prizrenit, bazuar në ftesën e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), për në Sofje të Republikës së Bullgarisë, të pjesëmarrje në vizitë studimore që ka për qëllim shkëmbimin e përvojave me zyrtarët nikoqir nga fusha e legjislacionit që punojnë në pushtetin lokal apo për pushtetin lokal. Vizita studimore do të realizohet nga data 22 prill 2025 deri me 25 prill 2025, në qytetin e lartcekur, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, pagesa e mëditjeve dhe shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurin.

2. Kjo vizitë përkrahet nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE).

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës- pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohen Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Kabineti i Kryetarit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 250/25 Dt. 15.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2, neni 34 paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, bazuar në Raportin nr. 01/030-36048 datë 21.03.2025 të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe pas rekomandimit nr. 001/030-39964 datë 27.03.2025 të Kuvendit të Komunës, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për lejimin e mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi aksidental i mjeteve piroteknike në lagjen Bazhdarhane

1. Me këtë Vendim, lejohen mjetet financiare për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi aksidental i mjeteve piroteknike i ndodhur me datën 31.12.2024 në lagjen Bazhdarhane në Prizren.

2. Personat që kompensohen konformë pikës 1 të këtij vendimi janë si në vijim:

   2.1. Ilir Beshi, lejohen mjetet financiare në shumën......................315.00 €,
   2.2. Arsim Gjinovci, lejohen mjetet financiare në shumën...... .....160.00 €,
   2.3. Hamit Nishori, lejohen mjetet financiare në shumën........... ..740.00 €,
   2.4. Neshe Cibo, lejohen mjetet financiare në shumën............. ...3000.00 €,
   2.5. Cyma Çoçaj, lejohen mjetet financiare në shumën........... ......189.84 €,
   2.6. Mërgim Bytyqi, lejohen mjetet financiare në shumën.............320.00 €,
   2.7. Gyner Nallënxhi, lejohen mjetet financiare në shumën...........132.00 €,
   2.8. Liridona Krasniqi, lejohen mjetet financiare në shumën.........230.00 €,
   2.9. Fahire Polis, lejohen mjetet financiare në shumën............. ....252.00 €,
   2.10. Memnune Kërpani, lejohen mjetet financiare në shumën......100.00 €,
   2.11. Nihad Avdi, lejohen mjetet financiare në shumën................ .142.62 €,
   2.12. Shkelzen Mekani, lejohen mjetet financiare në shumën........140.00 €,
   2.13. Alihajdar Bylbyli, lejohen mjetet financiare në shumën........244.00 €,
   2.14. Adelina Çipa, lejohen mjetet financiare në shumën.............. 477.00 €,
   2.15. Besart Kasumi, lejohen mjetet financiare në shumën........... 155.00 €,
   2.16. Lutfi Krasniçi, lejohen mjetet financiare në shumën.............1140.00 €,
   2.17. Ardian Buza, lejohen mjetet financiare në shumën................397.40 €,
   2.18. Sedat Ejupi, lejohen mjetet financiare në shumën.................760.00 €,

2.19. Xhemajl Çelaj, lejohen mjetet financiare në shumën............. 510.40 €,
2.20. Nehar Erciyas, lejohen mjetet financiare në shumën ..............350.00 €,
2.21. Edin Gurgushka, lejohen mjetet financiare në shumën...........800.00 €,
2.22. Xheladin Buqa, lejohen mjetet financiare në shumën............ 300.00 €,
2.23. Kreshnik Hoxha, lejohen mjetet financiare në shumën.......... 468.73 €,
2.24. Besmir Salahi, lejohen mjetet financiare në shumën.............. 995.00 €,
2.25. Xhevdet Osmani, lejohen mjetet financiare në shumën......... .142.62 €,
2.26. Edon Tamiku, lejohen mjetet financiare në shumën............... 212.80 €,
2.27. Miljaim Birdaini, lejohen mjetet financiare në shumën...........130.00 €,
2.28. Nebi Nebiu, lejohen mjetet financiare në shumën................... 420.00 €,
2.29. Këshilli i Banesës, lejohen mjetet financiare në shumën......... 804.00 €,
2.30. Abdyladi Alendar, lejohen mjetet financiare në shumën......... 120.00 €,

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.

4. Obligohet Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 255/25 Dt. 22.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr-28/2008), e në mbështetje të nenit 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr-20/2016), dhe nenin 50 shkronja j), si dhe 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. Muhamet Kurtaj, i sistemuar në vendin e punës-zyrtar i lartë ligjorë në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor në Komunën e Prizreni, që përveç detyrave të punës të përshkruara në aktemërimit, autorizohet që të udhëheq dhe menaxhon me stafin që është angazhuar për trajtimin e ndërtimeve pa leje në Komunën e Prizrenit.

2. I autorizuari si në pikën 1 të këtij vendimi, ka për detyrë dhe përgjegjësi që të udhëheq dhe menaxhon me stafin që është angazhuar për trajtimin e ndërtimeve pa leje në Komunën e Prizrenit, me kompetenca të plota konform legjislacionit në fuqi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij, dhe mbetet ne fuqi deri në një vendim tjetër.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Të lartcekurit,
- NJMBNJ,
- Organeve kompetente,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 257/25 Dt. 22.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e hartimit të projektit detal për projektin "Vrapuesja e Prizrenit" dhe për realizimin e këtij projekti , kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, nr. 54612.

3. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 256/25 Dt. 22.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së menaxherit të kontratës në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M
## Për lejimin e ndryshimeve në projekt

1. Miratohet kërkesa e menaxherit të kontratës në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për lejimin e ndryshimeve të pozicioneve (kolaudim të kontratës) në projektin: "Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve dhe i trotuareve me kupëza"-kontratë kornizë, i cili është duke u realizuar nga OE "Seferi-Co" shpk nga Suhareka, konform kontratës me nr. të prokurimit 622-23-687-5-1-1.

2. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit, OE "Seferi-Co" dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- OE "Seferi-Co",
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 259/25 Dt. 22.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M
## Për lejimin e ndryshimeve në projekt

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e ndryshimeve të pozicioneve (kolaudim të kontratës) në projektin: "Rregullimi i katër parqeve: "Kemajl Ataturku", "Ramë Bllaca", "Te semaforët në Ortakoll" dhe "Yllka" në Komunën e Prizrenit"-projekt dy vjeçar, i cili është duke u realizuar nga OE "NTB-ING" shpk, konform kontratës me nr. të prokurimit 622-23-7075-5-1-1.

2. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit, OE "NTB-ING" dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- OE "NTB-ING",
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 258/25 Dt. 22.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e realizimit të projektit: "Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve me kupëza, trotuareve dhe sheshеve në "Ortakoll", "Bajram Curr", "Arbanë", "Jeta e Re", etj., kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Kontrata do të jetë trevjeçare (kontratë kornizë).

3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, nr. 54596.

4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Sektorit të Prokurimit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 260/25 Dt. 22.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 27 të Rregullores nr. 001-011-151375 datë 13.11.2024 për Dhënien e Dekoratave nga Komuna e Prizrenit, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për formimin e Komisionit**

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për përzgjedhjen e modeleve të dekoratave. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:

   1.1. Vetan Xhemaj,......................kryesues,
   1.2. Nexhat Maçkaj,.....................anëtar,
   1.3. Shpejtim Rrahmanaj,..............anëtar.
   1.4. Fisnik Minci, .........................anëtar,
   1.5. Artan Xhaha,...........................anëtar.

2. Detyrat e Komisionit do të jenë: Të bëjë përzgjedhjen e modeleve të dekoratave konform konkursit publik të shpallur për përzgjedhjen e modeleve të dekoratave, Rregullores nr. 001-011-151375, datë 13.11.2024 për Dhënien e Dekoratave nga Komuna e Prizrenit dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi

3. Obligohet Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Komisionit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 265/25 Dt. 29.04.2025

PRIZREN

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 01 nr. 024/25, të datës 22.01.2025, që ka të bëj me shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet e Organizatave Jo Qeveritare (OJQ) dhe individëve nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit në Komunën e Prizrenit, kështu që, shumës prej 1.100.000.00 € (një milion e njëqindmijë euro) e caktuar (lejuar) si në pikën 1.2 të Vendimit bazik, i shtohen (lejohen) edhe 150.000.00 € (njëqind e pesëdhjetë mijë euro). Shuma e përgjithshme që lejohet është 1.250.000.00 € (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë euro)

2. Pjesët tjera të Vendimit 01 nr. 024/25, të datës 22.01.2025, mbesin të pandryshuara.

3. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 262/25 Dt. 29.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e hartimit të projektit detal për ndërtimin e rrugës "Jeta e Re"- "Bajram Curr", kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Shërbimeve Publike-mallra dhe shërbime.

3. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 263/25 Dt. 29.04.2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Marrëveshjes, 454-705/58 datë 18.03.2025 i nënshkruar mes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, DEMOS dhe Komunës së Prizrenit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e realizimit të projektit: "Ndërtimi i tregut të gjelbër dhe parkingut nëntokësor në Prizren", kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.

2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor-55742.

3. Ky projekt realizohet konform Marrëveshjes, 454-705/58 datë 18.03.2025,i nënshkruar mes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, DEMOS dhe Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➤ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- MAPL,
- DEMOS,
- Arkivës së Kryetarit.